



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr. 1579/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit .N.T.“M.B.” B.I., me NUI: 810991374, me seli Atmaxhë, në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.O., avokat nga Prizreni, kundër debitorit G-PROJECT SH.P.K, me seli në Rr. “Besim Shala”, me NUI: 810970716, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.R., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesat e kreditorit dhe debitorit të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2235/22 të datës 29.06.2023, me datë **01.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e Kreditorit .N.T.“M.B.” B.I., me seli Atmaxhë, në Prizren, dhe Debitorit G-PROJECT SH.P.K., me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 2235/22 të datës 29.06.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2235/22 të datës 29.06.2023, në pikën e I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit G-PROJECT SH.P.K, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.559/22 i datës 13.09.2022, nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,908.00 EUR. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit G-PROJECT SH.P.K, për pjesën e detyrimit në lartësi prej 2,312.00 EUR, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr. 559/22, i lejuar me datë 13.09.2022, nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha. Dhe në pikën III të dispozitivit ka përfunduar procedurën përmbartimore të kreditorit N.N.T. M.B.” B.I., sipas urdhrit P.nr.559/22 të datës 13.09.2022 për pjesën e detyrimit 1,908.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë:

- Kreditori N.T.“M.B.” B.I, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozimin që gjykata e shkallë se dytë ta rishikoj aktvendimin e shkallës së parë.

- Debitori debitorit G-PROJECT SH.P.K për shkak të shkeljeve të dispozitave themelore procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata të shkallë të dytë ta rishikoj aktvendimin në shkallë të parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**- Ankesat janë të pathemelta.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.“M.B.” B.I, dt. 28.05.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturës Nr. FSM-20-000017 të datës 05.05.2020 dhe Faturës Nr. FSM-17-000014 të datës 16.08.2017, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.559/22 të datës 13.09.2022, duke urdhëruar që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit shumën e mbetur prej 4,220.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet procedurale, me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e tyre të paguhet detyrimi nga debitori.

Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr. .559/22 të datës 13.09.2022, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar Urdhrin për lejimin e përmbartimit, për shkak se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbartues, nuk është dokument i besueshëm, ngase faturat nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që të njëjtat nuk janë pranuar nga personat kompetent dhe të njëjtat nuk janë të vullosura. Ka shtuar që në rastin konkret nuk është bashkëngjitur asnjë dokument mbështetës dhe të njëjtat janë lëshuar në kundërshtim me standardet e përcaktuara sipas Gjykatës Supreme me Aktvendimin CML.Nr. 24/2017 të datës 17.01.2018. Në lidhje me Faturën Nr. FSM-17-000014 të datës 16.08.2017, ka deklaruar se e njëjta është parashkruar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se përderisa debitori e ka përmbushur pjesërisht obligimin e kërkuar, atëherë kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit të kërkesës bazuar në dispozitat e nenit 368 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Në lidhje me pretendimet e palës debitore për mungesat në Faturën Nr. FSM-17-000014 të datës 16.08.2017, të njëjtat ka theksuar që nuk kanë bazë ligjore, sepse fatura është bashkëngjitur në origjinal. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri për përmbartim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2235/22 të datës 29.06.2023, në pikën e I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit G-PROJECT SH.P.K, ashtu që ka përfunduar pjesërisht Urdhri Përmbarrimor P.nr.559/22 i datës 13.09.2022, nga Përmbarruesi Privat Rushit Hoxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,908.00 EUR. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit G-PROJECT SH.P.K, për pjesën e detyrimit në lartësi prej 2,312.00 EUR, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhri përmbarrimor P.nr. 559/22, i lejuar me datë 13.09.2022, nga Përmbarruesi Privat Rushit Hoxha, Dhe në pikën III të dispozitivit e ka përfunduar procedurën përmbarrimore të kreditorit N.N.T. M.B.” B.I., sipas urdhrin P.nr.559/22 të datës 13.09.2022 për pjesën e detyrimit 1,908.00 euro, nga Përmbarruesi Privat Rushit Hoxha.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbarrimor P.nr. 559/22, i lejuar me datë 13.09.2022, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr: FSM-17-000014 të datës 16.08.2017, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Dhoma e Shkallës së Parë gjeti se Fatura Nr.FSM-17-000014 e datës 16.08.2017, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se e njëjta është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk është e nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim. Andaj pasi që gjykata vlerësoi se Fatura Nr.FSM-17-000014 e datës 16.08.2017, nuk i ka tiparet e dokumentit të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, si rrjedhojë nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe vendosi si në pikën I të këtij dispozitivit.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.559/22 të datës 13.09.2022 për shumën në vlerë prej 2,312.00 €, për faktin se Fatura Nr. FSM-20-000017 të datës 05.05.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është

përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Tutje dhoma e shkallës së parë në rastin konkret vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. FSM-20-000017 të datës 05.05.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Andaj Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 2,312.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbarimor për pjesën e borxhit prej 1,908.00€, ngase fatura Nr.FSM-17-000014 e dates 16.08.2017, nuk i ploteson kushtet e parapara me nenin 29 dhe neni 7 te LPP-së, meqense se fatura Nr.FSM-17-000014 nuk i ka tiparet e dukumentit te besueshme dhe nuk mund te permbarohet. gjykata nuk i shqyrtoi pretendimet tjera te debitorit, Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 29 dhe nenin 7 te LPP-së,” vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar prapësimin e debitorit për shkak të pagesës së borxhit ndaj kreditorit, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit në vlerë prej 2,312.00 EUR, pasi që fatura nr. Nr.FSM-17-000017 e datës 05.05.2020 prej të cilës buron ky borxh dhe është përshtatshëm për përmbarim, pasi që fatura në fjalë i plotëson të gjitha elementet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, ashtu që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të

drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë i analizoi edhe pretendimin e debitorit se një fature te tillë nuk dihet se perse është vendosur një obligim i tillë ndaj debitorit sepse nuk dihet personi përgjegjës për pranim te faturës ne fjalë. Po ashtu gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera te palëve ndërgjygjëse por i vlerësoi si te paqëndrueshme dhe te paargumentuara ne prova konkrete, jo siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, ashtu qe te njëjtat nuk ndikojnë ne një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si te pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1579/23 me datë 01.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**